

FJALA E GUVERNATORIT

I dashur lexues!

Është kënaqësi e veçantë të shkruaj faqet e para të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë. Në përmbyllje të një pune të devotshme dhe të suksesshme të institucionit që unë drejtoj, ky raport i përvitshëm transmeton opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet ekonomike e financiare në vend. Ai ofron, gjithashtu, në mënyrë të detajuar një pasqyrë të gjithë punës dhe aktiviteteve të Bankës së Shqipërisë në përmbushje të përgjegjësive të saj ligjore dhe angazhimeve institucionale. Siç e kemi theksuar në vazhdimësi, më shumë se një detyrim ligjor, Banka e Shqipërisë e shikon hartimin dhe publikimin e këtij raporti mbi të gjitha si një urë komunikimi mes bankës qendrore dhe publikut. Kjo filozofi e transparencës, e cila qëndron në themel të punës sonë, i shërben forcimit të besimit të publikut në Bankën e Shqipërisë si dhe rrit përgjegjshmërinë në përmbushjen e misionit tonë.

Viti që sapo lamë pas mund të konsiderohet një vit pozitiv për ekonominë shqiptare. Duke pasuar një goditje të fortë nga ambienti i jashtëm, ekonomia shqiptare arriti të shënojë rritje ekonomike, të konsolidojë stabilitetin makroekonomik dhe të shëndoshë sistemin financiar gjatë vitit 2010. Aktiviteti ekonomik u rrit në mënyrë progresive gjatë këtij viti, i ndihmuar edhe nga ecuria pozitive e ekonomisë botërore dhe nga dinamizmi i sektorit privat. Përmirësimi ekonomik reflektoi në të njëjtën kohë edhe politikën e duhura dhe të bashkërenduara makroekonomike të ndërmarra gjatë viteve të fundit. Tërheqja e stimulit fiskal dhe riorientimi i prioritetëve të politikës fiskale drejt qëndrueshmërisë afatgjatë të borxhit publik, u shoqërua me rritjen e stimulit monetar në ekonomi dhe lehtësimin progresiv të kushteve monetare e financiare në të. Pozicioni i jashtëm i ekonomisë shqiptare, me të drejtë i identifikuar prej kohësh si një ndër dobësitë strukturore të ekonomisë sonë, shënoi përmirësim gjatë vitit 2010. Në kontekstin e tregjeve financiare, viti që lamë pas është karakterizuar nga një funksionim më normal i tyre, nga rënia e primeve të rrezikut dhe e normave të interesit, si dhe nga një qëndrueshmëri relative e kursit të këmbimit.

Duke iu kthyer stabilitetit të çmimeve, i cili përbën edhe objektivin tonë kryesor dhe si i tillë orienton gjithë punën e vendimmarrjen tonë, viti 2010 shënoi një tjetër arritje pozitive. Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 3.6%, duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë për të. Efektet inflacioniste të gjeneruara nga goditjet e ofertës, nga rritja e çmimeve të administruara dhe nga kursi i nënçmuar i këmbimit, janë amortizuar nga politika e drejtë monetare. Kjo politikë ka krijuar kushte të përshtatshme ekonomike e monetare për të ruajtur inflacionin në nivel të ulët e të kontrolluar. Mbi të gjitha, ajo ka arritur të ankorojë pritjet afatmesme e afatgjata inflacioniste, duke reduktuar efektin e inflacionit në vendimmarrjen ekonomike dhe duke mbështetur në të njëjtën kohë zhvillimin e sistemit të brendshëm financiar.

Kjo politikë e Bankës së Shqipërisë është shoqëruar edhe me një punë aktive të Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit operacional të

Bankës së Shqipërisë, për përmirësimin e infrastrukturës financiare dhe të kuadrit mbikëqyrës e rregullator të sistemit bankar. Ndryshimi i kuadrit operacional të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, i ndërmarrë në muajin qershor, vendosi normat afatshkurtra të interesit të tregut ndërbankar si objektivin e operacioneve tona monetare, duke i shërbyer rritjes së efektivitetit të politikës monetare, si dhe nxitjes së funksionimit të tregut ndërbankar. Puna jonë do të vazhdojë më tej, duke synuar përmbushjen e të gjitha kushteve teknike për zhvillimin e një politike monetare moderne, në përputhje me filozofinë e regjimit të inflacionit të shënjestruar dhe të konvergencës së plotë me standardet e sistemit evropian të bankave qendrore. Përmirësimet rregullative e mbikëqyrëse, si dhe puna për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave, aktivitete këto të cilat janë pasqyruar në detaje në këtë raport, i kanë shërbyer ruajtjes së stabilitetit financiar të ekonomisë shqiptare, në nivel makro dhe mikroekonomik. Dy vjet pas goditjes që pësuan nga kriza ekonomike dhe financiare botërore, mund të konkludojmë së bashku se sistemi financiar shqiptar e përballoi me sukses sfidën dhe është tashmë në rrugën e rigjallërimit. Përmirësimi i likuiditetit, i rezultateve financiare dhe i treguesve të tjerë të prudencës gjatë vitit 2010 janë një tregues i rëndësishëm i kësaj tendence. Por, dhe mbi të gjitha, besimi i rivendosur i publikut mbetet dëshmitari kryesor i gjendjes së shëndetshme të sistemit dhe të institucioneve tona financiare.


Viti 2010 është mbyllur me një bilanc pozitiv edhe në aktivitete të tjera të Bankës së Shqipërisë. Kështu, është rritur cilësia e analizës dhe e parashikimit, është rritur vëllimi dhe cilësia e punës kërkimore dhe shkencore, ka vazhduar puna për rritjen e mëtejshme të cilësisë dhe përmirësimin metodologjik të statistikave të prodhuara në Bankën e Shqipërisë, janë shtuar aktivitetet në fushën e edukimit e të komunikimit me publikun dhe agjentë të tjerë ekonomikë, si dhe janë shtuar e forcuar më tej marrëdhëniet ndërinstitucionale brenda dhe jashtë vendit në shërbim të procesit të integritimit evropian të vendit dhe zhvillimit institucional të Bankës së Shqipërisë. Me të gjitha këto dhe të tjera aktivitete ju ftoj të njiheni duke shfletuar faqet e raportit në vazhdim.

Me kënaqësi, por edhe me një ndjenjë të shtuar përgjegjësie, konstatoj se Banka e Shqipërisë po merr gjithnjë e më tepër statusin e një ankore të stabilitetit ekonomik e financiar në ekonominë tonë. Ajo është gjithashtu një promotore e reformave strukturore në vend dhe një zë i respektuar në tryezat e diskutimit ekonomik. Nëpërmjet investimit të vazhdueshëm në rritjen e aftësive teknike e profesionale, Banka e Shqipërisë do të synojë ta ruajë e ta zhvillojë më tej këtë besim të publikut gjatë viteve në vazhdim.

Në mbyllje të kësaj hyrjeje, dëshiroj të shpreh edhe një herë vlerësimin tim për punonjësit e Bankës së Shqipërisë, puna e përkushtuar e të cilëve ka bërë të mundur arritjet e paraqitura në Raport.

Tiranë, Mars 2011,

Ardian FULLANI



Guvernator



E K S P O Z I T Ë
85 VJET
MONEDHË KOMBËTARE



